



Z. KH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 770 , datë 15.12.2021

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE "DEMOKRACIA",
VALIAS I RI, BASHKIA KAMZË DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË KAMZË
SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamzë, në masën 387 798 722 (treqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH.
2. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2021, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar në masën 77 559 744 (shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamzë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021.
3. Bashkia Kamzë caktohet si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamzë, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 6201/1
DATE 16.12.2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË KAMZË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI

